



**KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJËMBLEDHËS SEMAN**

VENDIM

Nr. 1 ,datë 07.02.2020

PËR

PËR MIRATIMIN E LEJES, PËR SHFRYTËZIM TË BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR, NË FSHATIN SHTYLLAS, BASHKIA KORÇË, QARKU KORÇË, PËR AMBALAZHIM NË SHISHE NGA SUBJEKTI DALIP HODO.

Në mbështetje të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.111/2012, i ndryshuar me ligjin 6/2018, datë 8.2.2018, për "Menaxhimin e integruar të burimeve ujore" VKM nr. 221, datë 26.4.2018, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore ", si dhe të VKM-së Nr. 416, datë 13.5.2015 si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr. 6, datë 12.6.2019, "Për miratimin e rregullores", "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor", Për pajisjen me leje për ambalazhim në shishe nga subjekti 'Dalip Hodo' me propozim të Z.A.B.U. Shkumbin-Seman.

Këshilli i Basenit Ujor Seman,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për shfrytëzimin e burimit ujor nëntokësor në fshatin Shtyllas, Bashkia Korçë, Qarku Korçë, me objektiv "Për ambalazhim në shishe" nga subjekti Dalip Hodo.
2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin-Seman për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I K B U S E M A N

BAKI BALA

